



STRATEGJIA

2020

Të bëjmë më shumë,
t'i bëjmë më mirë,
t'i çojmë më tej!





KRYQI I KUQ SHQIPTAR

Kryqi i Kuq Shqiptar (KKSJ) është krijuar më 4 tetor 1921 dhe është shoqata më e vjetër humanitare në vend. Ai është njohur zyrtarisht nga Komiteti Ndërkombëtar i Kryqit të Kuq në vitin 1923 dhe që nga ky vit është anëtar i Federatës Ndërkombëtare (në atë kohë Ligës) së Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjymhënës së Kuqe, duke qenë shoqata e 38-të e themeluar deri atëherë.

Me një veprimtari të admirueshme para dhe gjatë Luftës së Dytë Botërore, Kryqi i Kuq Shqiptar ndërtoi një profil perëndimor duke u mbështetur në përvojën më të mirë të shoqatave më të zhvilluara të Kryqit të Kuq të asaj kohe. Mirëpo pas luftës, shteti ia mori gradualisht pjesën dërrmuese të veprimtarisë dhe ia reduktoi ndjeshëm kapacitetet operacionale, duke bërë që shoqata të humbte shumë nga identiteti i vet, për t'u kthyer në një shtojcë propagande shëndetësore, plotësisht e varur nga organet shtetërore, të cilat me një vendim arbitrar të vitit 1969, ia kaluan Ministrisë së Shëndetësisë veprimtarinë e shoqatës.

Në fillim të viteve '90, rifillon sërish aktivitetin normal duke krijuar një bazë ligjore të plotë si dhe një strukturë organizative në forcim të vazhdueshëm.

Në bazë të nenit 1 të Ligjit Nr.7864 për Kryqin e Kuq Shqiptar, të miratuar nga Parlamenti Shqiptar më datë 29.9.1994, Kryqi i Kuq Shqiptar është një shoqatë humanitare vullnetare që e ushtron veprimtarinë në mënyrë të pavarur në bazë të Parimeve Themelore të Lëvizjes ndërkombëtare humanitare të Kryqit të Kuq e Gjysmëhënës së Kuqe dhe të Konventave të Gjenevës të 12 gushtit 1949 - ratifikuar nga Republika e Shqipërisë më 27 maj 1957 - dhe Protokolleve Shtesë të 10 qershorit 1977 - ratifikuar nga Republika e Shqipërisë më 16 qershor 1993. Ai është ndihmës i organeve të pushtetit për çështjet humanitare në mbarë vendin.

Kryqi i Kuq Shqiptar numëron 39 degë të shtrira në mbarë vendin. Ai ka arritur një zhvillim të mirë, duke u bërë shoqata humanitare më e madhe në vend. Në sajë të vullnetarëve të saj, shoqata është e pranishme në shoqërinë shqiptare kudo ku ka nevoja humanitare, pranë njerëzve të thjeshtë, në familjet përfituese apo komunitetet e ndryshme të prekur nga fatkeqësitë natyrore, të cilët e shohin Kryqin e Kuq Shqiptar si një shpresë për lehtësimin e vuajtjeve të tyre.

Çdo gjë që ne themi dhe bëjmë frymëzohet nga Parimet Themelore të Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëhënës së Kuqe:

- Humanizmi
- Paanësia
- Neutraliteti
- Pavarësia
- Vullnetarizmi
- Uniteti
- Universaliteti.



Gjatë kësaj periudhe, ne e kemi zhvilluar shoqatën tonë, kemi rritur praninë e saj në shoqërinë shqiptare, kemi ngritur dhe zgjeruar rrjetin e vullnetarëve, kemi rritur nivelin e transparencës, kemi forcuar llogaridhënien, si dhe kemi evidentuar dhe shtuar partnerët tanë.

Ne kemi treguar vlerat tona në organizimin e operacioneve të ndihmës humanitare gjatë krizave dhe katastrofave që kanë prekur vendin tonë, duke ndihmuar një numër të madh njerëzish në nevojë. Ne gjithashtu kemi qenë aktivë në dhënien e mbështetjes sociale e shëndetësore për komunitetet në nevojë, duke ndikuar në zvogëlimin e vulnerabilitetit të tyre. Jemi angazhuar gjithashtu për të përcjellë shqetësimin dhe interesat e njerëzve në nevojë, në strukturat vendimmarrëse.

Në të njëjtën kohë kemi identifikuar një sërë fushash për t'u përmirësuar. Kështu duke kaluar nga Strategjia 2010-2015 në Strategjinë 2016-2020, ne duam që të bëjmë më shumë, t'i bëjmë më mirë dhe të shkojmë më tej.

Ne synojmë::

- Të rrisim më tej rolin ndihmëdhënës të shoqatës për çështjet humanitare në mbarë vendin nëpërmjet një zhvillimi të qëndrueshëm të kapaciteteve njerëzore, materiale dhe financiare.
- Të forcojmë strukturat e zgjedhura e menaxhuese dhe pavarësinë e tyre, si në nivel qendror edhe në atë lokal, duke respektuar diversitetin e mendimeve.
- Të rrisim fushat e ndërhyrjes dhe nivelin e ekspertizës gjatë ofrimit të shërbimeve tona për publikun.
- Të zgjerojmë fokusin e aktiviteteve tona në rastet e katastrofave dhe krizave.
- Të gjejmë rrugë më të përshtatshme për të punuar së bashku, në mënyrë që të gjitha kapacitetet tona të shkojnë në kohë dhe në mënyrë sa më efektive në shërbim të njerëzve më në nevojë, duke qenë më të hapur për të bashkëpunuar edhe me partnerë të tjerë jashtë Lëvizjes.
- Të rrisim nivelin e të bërit avokati duke folur më shumë dhe me zë më të lartë në emër të njerëzve në nevojë, duke iu përmbajtur njëkohësisht Parimeve Themelore të Lëvizjes.
- Të përafrojmë dhe harmonizojmë punën me Federatën tonë në konsolidimin e strukturave drejtuese, proceset e planifikimit, të menaxhimit, të administrimit dhe të llogaridhënies.

STRATEGJIA E KRYQIT TË KUQ SHQIPTAR 2016-2020

Strategjia e Kryqit të Kuq Shqiptar për vitet 2016-2020 është rezultati i një vlerësimi dhe reflektimi gjithëpërfshirës të strukturave të Kryqit të Kuq Shqiptar në të gjitha nivelet, vullnetarë, të zgjedhur dhe të punësuar.

Me këtë strategji ne synojmë që të çojmë më tej arritjet e deritanishme, të rrisim fushat e ekspertizës, të forcojmë pozicionin e Kryqit të Kuq Shqiptar si partner ndihmës i qeverisjes dhe lider mes shoqatave të tjera për çështjet humanitare në mbarë vendin.



Kjo strategji merr në konsideratë arritjet e shoqatës në këto 25 vitet e fundit, ndryshimet social-ekonomike në vend dhe më gjerë si dhe pasojat nga ndryshimet globale, duke qëndruar njëkohësisht në një linjë me Strategjinë e Federatës Ndërkombëtare të Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëdhënës së Kuqe.



SITUATA E VENDIT

Sipas të dhënave të Institutit të Statistikave, popullsia e Shqipërisë më 1 Janar 2015 arriti në 2.893.005 banorë. Raporti gjinor i popullsisë është 102,1 meshkuj për çdo 100 femra. Moshë mesatare e popullsisë është 35 vjeç.

Vendi vazhdon të jetë një nga më të varfrit në Europë. Niveli i varfërisë është rritur me 14.3% që nga viti 2008. Varfëria ekstreme (vështirësi për të përballuar nevojat ushqimore bazë) u rrit nga 1.2 % në 2008, në 2.2% në 2014. Ajo ka pësuar rritje si në zonat urbane ashtu edhe në ato rurale. Treguesit e varfërisë në % sipas qarqeve rendisin Kukësin, Lezhën, Fierin me përqindjen më të lartë, respektivisht 22,5%, 18, 4% dhe 17,1 %.

Shkaku kryesor i varfërisë është papunësia. Niveli i papunësisë u rrit me 12.5% në 2008 dhe me 18% në 2014². Mungesa e vendeve të punës është më e theksuar te të rinjtë dhe te gratë. Kriza ekonomike globale e viteve të fundit ka çuar në uljen e nivelit të remitançave, një të ardhure të rëndësishme për familjet shqiptare, gjë që ka ndikuar në rritjen e nivelit të varfërisë. Si rrjedhim një numër i madh shqiptarësh kanë kërkuar azil, kryesisht në Gjermani, për arsye ekonomike. Ndërkohë shumë prej tyre janë riatdhësuar dhe shumë të tjerë pritet të kthehen.

Fëmijët, të cilët kanë qenë gjithmonë një grup target për Kryqin e Kuq Shqiptar, vuajnë më së shumti pasojat afatshkurtra dhe afatgjata të varfërisë, që shpesh do të thotë shëndet i keq, arsim jocilësor, privim nga mundësi dhe oportunitete që do

¹ INSTAT, Njoftim për Shtyp, 2015: <http://www.instat.gov.al/al/publications/njoftim-për-media/njoftim-për-media-popullsia-e-shqipërisë-1-janar-2015.aspx>

² Raporti për Shqipërinë 2015, Komisioni European

të ndryshojnë jetën e tyre si të rritur. Shpesh fëmijët janë dhe viktima të dhunës në familje. Përsa u përket të rinjve shqiptarë problemet aktuale me të cilat ndeshen ata janë mungesa e formimit të përshtatshëm profesional në përputhje me kërkesat e tregut, arsimi i lartë me kosto të lartë, papunësia, etj.

Përfshirja e grave në jetën politike dhe në vendimmarrje ka ardhur duke u rritur, duke shënuar një progres të dukshëm, por përfshirja e tyre në tregun e punës është ende e ulët. Pavarësisht ndryshimeve pozitive në legjisllacion, gratë dhe vajzat vazhdojnë të jenë viktima të dhunës me bazë gjinore. Sipas një studimi kombëtar për dhunën në familje 59.4% e grave kanë përjetuar dhunë në familje gjatë jetës së tyre³. Në vitin 2014 numri i grave të dhunuara ishte 3,090⁴.

Të moshuarit janë një tjetër kategori e disfavorizuar. Shumë prej tyre jetojnë në varfëri dhe kanë akses të pamjaftueshëm në shërbimet shëndetësore e sociale. Mbështetja e familjarëve, dikur shtylla kryesore e mbrojtjes dhe e kujdesit për moshën e tretë, ka ardhur duke u ulur.

Sistemi shëndetësor në Shqipëri është përballë sfidave të mëdha. Cilësia e shërbimit shëndetësor nuk është e njëjtë kudo dhe veç kësaj këto shërbime nuk janë efçente, çka ndikon negativisht në shëndetin e popullatës. Vdekshmëria foshnjore për 1.000 lindje në 2014 ishte 7,8 për meshkujt dhe 8,0 për femrat.

Shqipëria është një vend i rrezikuar nga katastrofat natyrore, kryesisht përmbytjet gjatë viteve të fundit. Mungesa e marrjes së masave parandaluese, për shkak të mungesës së investimeve, e rrisin edhe më tepër shkallën e rrezikut dhe vulnerabilitetin e njerëzve, veçanërisht të atyre që jetojnë në varfëri.

Numri i aksidenteve automobilistike në Shqipëri është relativisht i lartë. Viti 2014 shënoi 1.914 aksidente në të gjithë vendin, me pasojë vdekjen në 264 raste⁵. Arsyet kryesore lidhen me mungesën e sinjalistikës, mosrespektimin e rregullave të qarkullimit rrugor, etj.

Reforma administrative dhe territoriale, me uljen drastike të numrit të njësive vendore nga 374 bashki e komuna në 61 bashki, krijon mundësi më të mëdha për organizatat joqeveritare për bashkëpunim më efikas me strukturat vendore. Decentralizimi do t'u japë më shumë kompetenca bashkive, çka teorikisht do të thotë shërbime më pranë nevojtarëve. Praktikisht kompetencat e reja do të kenë nevojë për shoqërimin me buxhete të mjaftueshme, investime dhe burime njerëzore, të cilat në numër dhe përgatitje teknike duhet të jenë në gjendje t'i përballojnë nevojat në zonat urbane dhe rurale brenda territoreve më të mëdha që kanë në menaxhim tashmë bashkitë.

3 Domestic Violence in Albania. A national population-based survey, INSTAT and UNDP (2013)

4 INSTAT, Femra dhe Meshkuj në Shqipëri, 2015

5 INSTAT, Femra dhe Meshkuj në Shqipëri, 2015

6 INSTAT, Femra dhe Meshkuj në Shqipëri, 2015

VIZIONI

Një shoqëri ku të gjithë marrin në kohë dhe me cilësi ndihmën dhe mbështetjen që u nevojitet në situata vulnerabiliteti.

MISIONI

Kryqi i Kuq Shqiptar synon të zhvillojë dhe të promovojë, në çdo kohë dhe në të gjitha format, veprimtaritë humanitare, me qëllim që të parandalojë dhe të lehtësojë vuajtjet e njerëzve, duke ruajtur dinjitetin e tyre.

ÇFARË DO TË BËJMË!

Duke marrë në konsideratë një botë në ndryshim, një popullsi gjithmonë në lëvizje për një jetë më të mirë, nevojat e ndryshme të komuniteteve që përballen çdo ditë me situata të vështira social-ekonomike, duke u udhëhequr nga të drejtat dhe liritë që çdo njeri duhet të ketë, Strategjia 2016-2020 është hartuar në mënyrë të tillë që shërbimi që të gjithë presin prej nesh, të jetë maksimal, duke kontribuar në ndërtimin e një shoqërie më humane, më dinjitoze dhe më të paqte.

Ne do t'i përforcojmë arritjet e deritanishme duke e përqendruar punën tonë në 3 qëllime strategjike:





QËLLIMI STRATEGJIK I
Të ruajmë jetën dhe të lehtësojmë vuajtjet e njerëzve që preken nga katastrofat dhe krizat.



QËLLIMI STRATEGJIK II
Të forcojmë reziliencën e komuniteteve për të mundësuar një jetesë të sigurt dhe të shëndetshme.



QËLLIMI STRATEGJIK III
Të promovojmë përfshirjen sociale dhe një kulturë të gatishmërisë vullnetare për të ndihmuar.

SI DO TË PUNOJMË:

1. Të jemi një shoqatë e fortë.
2. Të zhvillojmë më tej elementet e diplomacisë humanitare.
3. Të bashkëpunojmë në mënyrë më efektive dhe transparente

- **Qëllimi i parë strategjik:** Të ruajmë jetën dhe të lehtësojmë vuajtjet e njerëzve që preken nga katastrofat dhe krizat, duke synuar forcimin e rolit ndihmëdhënës dhe duke konfirmuar angazhimin tonë për të qenë aktor lider në veprimtarinë humanitare.
- **Qëllimi i dytë strategjik:** Të forcojmë reziliencën⁷ e komuniteteve për të mundësuar një jetesë të sigurt dhe të shëndetshme, duke synuar konsolidimin dhe zgjerimin e shërbimeve që ne ofrojmë dhe ndihmën në gjetjen e zgjidhjeve për të bërë më shumë në parandalimin dhe zvogëlimin e shkaqeve të vulnerabilitetit.
- **Qëllimi i tretë strategjik:** Të promovojmë përfshirjen sociale dhe një kulturë të gatishmërisë vullnetare për të ndihmuar.

Rëndësia e Strategjisë qëndron në faktin se shoqata jonë, nën shembullin e Federatës, do të bëjë *më shumë dhe më mirë* për të mbështetur njerëzit më në nevojë, duke marrë në konsideratë nevojat konkrete të tyre. Anëtarët, vullnetarët dhe punonjësit do të jenë më aktivë dhe më të motivuar. Të gjithë së bashku do të jemi më eficientë dhe më bindës në avokatinë që do të bëjmë në emër të nevojave, duke luftuar për respektimin e të drejtave të grupeve më në nevojë.

⁷ Shënim: Reziliencia është aftësia për ta marrë veten pas një goditjeje apo dëmi. Në këtë dokument fjala “reziliencë” i referohet qëndrueshmërisë, rezistencës dhe rimëkëmbjes së komuniteteve.

QËLLIMI STRATEGJIK

Të ruajmë jetën dhe të lehtësojmë vuajtjet e njerëzve që preken nga katastrofat dhe krizat

Përgatitje, gatishmëri dhe përgjigje ndaj katastrofave dhe krizave.

Gjatë një katastrofe të shkaktuar nga natyra apo nga njeriu, nevojë imediate është ruajtja dhe mbrojtja e jetëve të njerëzve, lehtësimi i vuajtjeve, zvogëlimi i dëmeve e i humbjeve dhe mbështetja psiko-sociale e njerëzve të prekur. Për të kontribuar në këto aspekte, roli dhe angazhimi ynë bazë është që të përgatitemi mirë dhe të jemi në gatishmëri për të përdorur të gjitha mundësitë tona për të vepruar në kohë dhe me efektivitet.

Çdo ndërhyrje humanitare duhet të jetë gjithëpërfshirëse dhe ndihma duhet t'iu ofrohet njerëzve më në nevojë dhe të ofrohet në atë mënyrë që të respektohen të drejtat dhe dinjiteti i tyre.

Përgatitja dhe përgjigja ndaj katastrofave dhe krizave.

Për t'u parapërgatitur për një ndërhyrje humanitare efikase në rastet e katastrofave dhe krizave:

- Ne konsolidojmë rrjetin e vullnetarëve dhe sigurojmë trajnimin e vazhdueshëm të tyre.
- Ne punojmë për përmirësimin e planeve të gatishmërisë në të gjitha nivelet, veçanërisht në degë.
- Ne marrim masa për sigurimin e fondeve rezervë dhe pasjen e një stoku me artikuj bazë të nevojshëm, gatishmërinë logjistike dhe një sistem efikas komunikimi.
- Ne u përgjigjemi katastrofave apo krizave kur ato ndodhin, duke vazhduar me mbështetjen me pako ushqimore, ujë dhe kite higjienike si dhe ofrojmë njëkohësisht shërbime të tjera, si ndihma e parë, mbështetje psiko-sociale dhe shëndetësore bazë, etj.
- Ne punojmë për të lehtësuar ankthin dhe vuajtjet e familjeve të ndara duke ofruar shërbimin e rivendosjes së lidhjeve familjare, kur ato janë ndërprerë si rrjedhojë e katastrofave dhe krizave.

- Ne kontribuojmë në sigurimin e strehimit të emergjencës, duke bashkërenduar njëkohësisht punën tonë me atë të strukturave të tjera që e ofrojnë këtë shërbim.

Rimëkëmbja nga katastrofa dhe kriza

Ne angazhohemi në rikuperimin nga katastrofat dhe krizat, duke ofruar:

- Mbështetje në parandalimin e dëmtimeve dhe humbjeve të mëtejshme, duke kontribuar në rivendosjen e shërbimeve bazë në komunitet.
- Ne harmonizojmë planet për rastet e katastrofave me strukturat brenda vendit si dhe me komponentët e Lëvizjes Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe të Gjysmëhënës së Kuqe (KNKK, FNKK, SHK).
- Ne punojmë për hartimin dhe zbatimin e procedurave standarde të veprimit në rastet e emergjencave nga çdo strukturë e KKSH.
-

Rezultatet e pritshme

- Konsolidimi i strukturave vullnetare dhe rritja e kapaciteteve materiale e financiare për të vepruar në kohë dhe me efektivitet në raste katastrofash dhe krizash.
- Lehtësimi i vuajtjeve të familjeve më të prekura nga katastrofat ose krizat.
- Kontribut në kthimin në normalitet të komuniteteve të prekura.



Të forcojmë reziliencën e komuniteteve për të mundësuar një jetesë të sigurt dhe të shëndetshme

Kontributi ynë specifik për këtë qëllim strategjik do të jetë për një zhvillim të qëndrueshëm të komuniteteve si dhe rritjen e aftësive të tyre përballuese.

Nëpërmjet ndërhyrjes sonë ne synojmë::

- Forcimin apo aftësimin e komunitetit, duke i ndihmuar njerëzit që të jenë sa më të shëndetshëm.
- Rritjen e aftësive të komuniteteve në rrezik për t'u përballuar me pasojat dhe rikthimin e jetës së tyre në normalitet.
- Ndërgjegjësimin dhe rritjen e ndjeshmërisë së komunitetit për rreziqet dhe ndryshimet klimatike.

Për një shëndet më të mirë

- Ne nxisim veprimtaritë që kontribuojnë në një shëndet të mirë, duke vënë theksin në faktorët lokalë, që ndikojnë ndjeshëm në parandalimin dhe zvogëlimin e vdekshmërisë, sëmundjeve, dëmtimeve dhe paaftësisë.
- Ne kontribuojmë në uljen e vulnerabilitetit të individit dhe komuniteteve nëpërmjet ofrimit të aktiviteteve ndërgjegjësuese rreth shëndetit të nënës dhe të fëmijës, shëndetit riprodhues, nëpërmjet shpërndarjes së njohurive mbi higjienën personale dhe asaj në komunitet, si dhe të njohurive mbi parandalimin e sëmundjeve infektive si p.sh. SIDA dhe tuberkulozi, përmes rritjes së vëmendjes ndaj sigurisë rrugore, përmes promovimit dhe mbrojtjes së mjedisit, si dhe përmes përmirësimit të kushteve në punë, rrugë dhe shtëpi.
- Ne kontribuojmë në përfshirjen e sa më shumë njerëzve në nevojë në shërbimet publike shëndetësore, duke përfshirë këtu shërbimet në situatat e emergjencës.
- Ne kontribuojmë në krijimin e një kulture gjithëpërfshirëse për dhurimin vullnetar të gjakut dhe rrisim ndërgjegjësimin për gjak të sigurt.
- Ne kontribuojmë në promovimin dhe dhënien e njohurive për Ndhimën e Parë, duke përdorur teknika bashkëkohore.



Nëpërmjet rrejtit tonë vullnetar, ne synojmë të arrijmë publikun e gjerë, në veçanti të rinjtë për të nxitur dhe mbështetur përpjekjet afatgjata të ndryshimit të sjelljes, që ju mundësojnë njerëzve një jetë të gjatë dhe produktive.

Reduktimi i rrezikut nga fatkeqësitë

- Ne shpërndajmë informacion për rreziqet dhe mjetet e mbrojtjes tek njerëzit, veçanërisht tek ata që jetojnë në zonat me rrezikshmëri të lartë, duke shfrytëzuar dijet, inovacionin, edukimin formal dhe jo formal.
- Ne promovojmë përfshirjen e njohurive rreth rreziqeve dhe masave mbrojtëse në kurrikulat shkollore.
- Ne bëjmë avokati për përmirësimin e ligjeve dhe politikave për reduktimin e rrezikut.

Mbështetje sociale

- Ne punojmë që të përmirësojmë nivelin e jetesës për grupet në nevojë, si të moshuarit e vetmuar, gratë dhe vajzat në rrezik, fëmijët dhe të rinjtë në vështirësi, viktimat e trafikimit, refugjatët dhe migrantët, si dhe pjesëtarët e minoriteteve.
- Ne kontribuojmë në fuqizimin dhe ruajtjen e autonomisë së grupeve vulnerabël duke ofruar mbështetje sociale, siç është formimi profesional, në mënyrë që ata të kenë më shumë mundësi punësimi, mbështetje për një edukim cilësor dhe integrim social, shërbime mjekësore të përshtatshme, sigurimi të bazës ushqimore për të përmirësuar gjendjen e tyre ekonomike, duke promovuar të drejtat themelore të njeriut.

Rezultatet e pritshme

- Komunitetet janë më pak të ekspozuara dhe më pak vulnerabël ndaj rreziqeve dhe katastrofave.
- Komunitetet dhe individët janë më të shëndetshëm dhe kanë më shumë akses në shërbimin shëndetësor publik.
- Jetesa dhe shëndeti i komuniteteve përmirësohet si rezultat i shërbimeve dhe veprimtarive më cilësore dhe afatgjata.

Të promovojmë përfshirjen sociale dhe një kulturë të gatishmërisë vullnetarë për të ndihmuar.

Pavarësisht zhvillimeve pozitive në vend, në mesin e komuniteteve ka grupe të njerëzve të cilët janë të përjashtuar nga shoqëria për shkak të statusit të tyre të pafavorshëm social-ekonomike, të cilët nuk gëzojnë përfitimet e përgjithshme publike.

Gjatë punës sonë në promovojmë një shoqëri në të cilën njerëzit mund të angazhohen me vullnetin e tyre të lirë për të ndihmuar njerëzit e pambrojtur dhe vulnerabël.

Nëpërmjet vullnetarëve tanë dhe të rrjetit rinor ne bëjmë avokati për një njohje më të gjerë dhe një zbatim më të mirë të Parimeve tona Themelore dhe të Drejtës dhe Vlerave Humanitare.

Gjatë ndërhyrjes tonë, ne synojmë

- Të mbështesim dhe të avokojmë për grupet në nevojë të cilët nuk janë në gjendje të gëzojnë përfitimet e përgjithshme të shoqërisë dhe që ata të kenë qasje më të madhe në shërbimet publike që ofrohen.
- Ne promovojmë dhënien e njohurive mbi Parimet Themelore, Vlerat Humanitare dhe të Drejtën Ndërkombëtare Humanitare për profesionistët dhe publikun e gjerë.

Integrim më il mirë e grupeve vulnerabël

- Ne mbështesim dhe bëjmë avokati për grupet vulnerabël, të cilët për shkak të situatës së tyre social-ekonomike të vështirë, të papunësisë, dhunës apo diskriminimit, janë të marginalizuar ose të përjashtuar nga përfitimi i shërbimeve të përgjithshme të shoqërisë.
- Ndihma jonë është projektuar dhe zhvilluar së bashku me përfituesit tanë duke përdorur pikat e tyre të forta si një bazë solide për fuqizimin e vazhdueshëm të tyre.

Promovimi il Parimeve dhe Vlerave humanitare

- Gjatë ndërhyrjes sonë humanitare, ne sigurojmë një mjedis mikpritës, ku njerëzit në nevojë ndihen të sigurt, të pa paragjykuar, të mbrojtur, dhe me mundësinë për të marr pjesë aktivisht në punën tonë.

- Ne promovojmë përfshirjen e komunitetit dhe krijimin e një kulture për ndihmën humanitare.
- Ne promovojmë të drejtën humanitare ndërkombëtare dhe kontribuojmë në ndërtimin e një kulturë të re të vullnetarizmit.

Rezultatet e pritshme

- Rritja e angazhimit të komuniteteve në veprimtaritë humanitare.
- Akses më i madh i kategorive në vështirësi në shërbimet e përkujdesit social dhe integrimin e tyre në shoqëri.
- Komuniteti ka marrë njohuritë e nevojshme për të drejtën humanitare dhe vullnetarizmin.

SI DO TË: PUNOJMË?

Duke pasur në vëmendje se qëllimi ynë kryesor është që të parandalojmë dhe të lehtësojmë vuajtjet e njerëzve duke mbrojtur dinjitetin e çdo personi të vetëm, ne duhet të mobilizojmë të gjitha mjetet dhe burimet efikase që kemi në dispozicion dhe të veprojmë në tre drejtime kryesore:

1. Të jemi një shoqatë që funksionon mirë.
2. Të zhvillojmë më tej elementet e diplomacisë humanitare.
3. Të bashkëpunojmë në mënyrë më efikase dhe transparente.

1..Të jemi një shoqatë e fortë

Themeli i një shoqate të fortë është baza ligjore e saj. Kjo bazë ligjore duhet të marrë në konsideratë zhvillimet e reja dhe ndryshimet që dikton koha. Ajo duhet të jetë në koherencë me sfidat e kohës dhe t'iu japë zgjidhje situatave të reja, me të cilat përballet shoqëria në përgjithësi dhe shoqata në veprimin e saj humanitar në veçanti.

Prandaj është e nevojshme që në këtë Strategji të bëhet rishikimi i Ligjit të KKSJ dhe Emblemës si dhe i dokumenteve të tjera bazë të shoqatës si Statutit, Politika, Rregulloreve, etj.

Që shoqata të funksionojë mirë duhet të kemi të përcaktuara qartë rolet dhe përgjegjësitë e strukturave drejtuese dhe menaxhuese, si edhe rregullimet e brendshme të komunikimit efektiv midis tyre. E nëse shoqata jonë këtë ndarje të roleve e ka të mirë përcaktuar në dokumentet bazë të saj, mbetet detyrë zbatimi praktik në seli dhe sidomos në 39 degët e saj. Për këtë nevojitet një punë

sistematike për njohjen e dokumenteve bazë të shoqatës dhe pjesëmarrje aktive e të zgjedhurve në veprimtaritë humanitare që organizohen.

Zemra e një shoqate të fortë janë anëtarët dhe, në veçanti, vullnetarët e saj, të cilët përfaqësojnë grupe të ndryshme të shoqërisë, pa asnjë dallim, dhe që sjellin prej saj shqetësimet dhe nevojat të cilat janë një burim i rëndësishëm për organet vendimmarrëse në hartimin e projekteve, aktiviteteve apo veprimtarive të ndryshme.

Në një fokus të veçantë për shoqatën janë të rinjtë, të cilët ajo i konsideron si një investim tepër të rëndësishëm, jo vetëm për të sotmen por edhe për të ardhmen. Shoqata angazhohet që të përmirësojë cilësinë, standardet dhe kapacitetet e trajtimit të vullnetarëve, duke krijuar një mjedis mikpritës dhe gjithëpërfshirës

Duke pranuar arsimimin e tyre bashkëkohor, duke shfrytëzuar aftësitë e tyre inovatore si njohës të mirë të teknologjisë moderne të komunikimit, shoqata i rekruton të rinjtë në strukturat e saj drejtuese, i angazhon në punët vullnetare, në zbatimin e projekteve dhe i motivon si përfitues.

Të rinjtë si lider

Promovimi dhe rritja e rolit të lidërshiptit tek të rinjtë në drejtim të vendimmarrjes, ofrimit të shërbimeve, rolit të ndihmësit për njerëzit në nevojë dhe partneritetit.

Të rinjtë si vullnetarë

Promovimi dhe zhvillimi i vullnetarizmit tek të rinjtë, si një angazhim qytetar në drejtim të promovimit të vlerave humanitare.

Të rinjtë si përfitues

Promovimi i Parimeve Themelore të Lëvizjes dhe edukimit humanitar tek të rinjtë, si mjete për të ndryshuar mendimet, për të shpëtuar jetë dhe për të rritur tolerancën.

Komunitetet e qëndrueshme e bëjnë shoqërinë në tërësi më të fortë. Në çdo komunitet pavarësisht se sa i varfër është, ekzistojnë kapacitete njerëzore që duhet të mobilizohen nga shoqata për të identifikuar dhe për të ndihmuar njerëzit më në nevojë.

Nevoja për të qenë më afër komuniteteve dikton domosdoshmërinë e degëve më të forta, zgjerimin e pikave të kontaktit të përshtatura me ndryshimet e reja të njësive administrative, mbështetur nga staf, anëtarë dhe vullnetarë.

Çdo vit, ne përcaktojmë planin e veprimit të bazuar në analizën e nevojave, vulnerabilitetin e popullsisë së synuar për t'u ndihmuar, duke marrë parasysh kapacitetet dhe burimet e qëndrueshme të shoqatës.

Rezultatet e pritshme

- Bazë ligjore e rishikuar dhe e njohur nga të gjitha strukturat në nivel qendror dhe lokal.
- Shoqatë kombëtare e qëndrueshme që funksionon mirë si në nivel qendror ashtu edhe lokal.
- Pjesëmarrje më e madhe e të rinjve në drejtim, dhe në veprimtarinë e Shoqatës.

2. Të zhvillojmë më tej elementet e diplomacisë humanitare

Diplomacia humanitare në thelb ka të bëjë me bindjen e drejtuesit, vendimmarrësit dhe opinionit të gjerë, për të vepruar në çdo kohë në interes të njerëzve në nevojë dhe në respekt të plotë të Parimeve Themelore të Lëvizjes.

Siç përkufizohet në politikën e Federatës Ndërkombëtare të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe, diplomacia është një përpjekje shumëdimensionale, që nxjerr në pah nevojat dhe të drejtat e njerëzve. Ajo synon t'iu japë atyre një zë të fuqishëm në të gjitha proceset e negociatave. Roli i KKSJH është që të bëjë përpjekje të vazhdueshme për të adresuar në strukturat e shtetit shqiptar vëmendjen ndaj kategorive sociale në nevojë dhe gjetjen e zgjidhjeve për lehtësimin e vuajtjeve të tyre.



KKSH si partner i qeverisë për çështjet humanitare

Qeveritë janë përgjegjësit kryesorë për të adresuar dobësitë që ekzistojnë në vendet e tyre, ndërsa shoqatat kombëtare kanë rolin e ndihmësit, pra rol plotësues, në përmbushjen e kësaj përgjegjësie. Roli i ndihmësit dëshmon neutralitetin tonë në hapësirën e veprimtarisë humanitare dhe na mundëson që ne të veprojmë lirisht dhe pa pengesë, për t'iu shërbyer njerëzve të pambrojtur.

Kryqi i Kuq Shqiptar gëzon një shkallë të lartë pavarësie dhe autonomie për të vepruar në përputhje me mandatin dhe rolin e tij ndihmës në Shqipëri. Në përgjithësi, marrëdhënia me autoritetet qeveritare është e mirë; Shoqata Kombëtare ka marrëdhënie të mira me ministri të ndryshme, departamente dhe organet e tjera qeveritare dhe ekziston një bashkëpunim i ndërsjellë, sidomos gjatë situatave të fatkeqësive apo krizave.

Në këtë kuptim KKSH krijon dhe i forcon marrëdhëniet me autoritetet publike në mënyrë të atillë që ato të jenë të bazuara në besimin reciprok dhe në përputhje me bazën ligjore dhe statusin tonë si ndihmës të organeve qeverisëse.

Roli i KKSH si partner ndihmës shfaqet në aspektet e mëposhtme

- Pjesëmarrja dhe bashkëpunimi i Shoqatës Kombëtare në zbatimin e detyrimeve të shtetit në përputhje me të drejtën ndërkombëtare dhe rezolutave të Konferencës Ndërkombëtare të KK dhe GJHK për çështje bashkëpunimi me detyra të ndërlidhura, si menaxhimi i fatkeqësive, ndihma e parë dhe siguria rugore, shëndetësia dhe shërbimet sociale, rivendosja e lidhjeve familjare, etj.

- Pjesëmarrja në dialog me autoritetet publike në të gjitha nivelet për t'iu konsultuar rreth çështjeve humanitare dhe përdorimit të burimeve të brendshme dhe ndërkombëtare në raste fatkeqësish.

- Krijimi nga shteti i një mjedisi të përshtatshëm për KKSH, duke përfshirë përshtatjen e legjisllacionit dhe rregullimet e tij, përdorimin e emblemës, mbështetjen me burime materiale dhe financiare, të cilat përdoren për të realizuar aktivitetet humanitare, dhe mbështetje të tjera që lehtësojnë punën e shoqatës, si shërbimi vullnetar, shërbimi doganor, lehtësitë tatimore etj.

Në nivel kombëtar dhe lokal, zëri ynë shkon për të tërhequr vëmendjen ndaj mbrojtjes së njerëzve vulnerabël dhe ndihmës ndaj tyre, të cilët duhet të jenë në gjendje të shprehin nevojat e tyre, realizojnë të drejtat e tyre dhe të kenë më shumë akses në shërbimet publike. Ne gjithashtu kërkojmë mënyra për të adresuar shkaqet e vuajtjeve të tyre dhe për të parandaluar apo reduktuar dobësitë e tyre

e në këtë mënyrë për të qenë më të përgatitur në parandalimin dhe përbalimin e katastrofave dhe krizave.

Ne bëjmë avokati për legjislacionin kombëtar, zhvillimin e planeve dhe strategjive për menaxhimin e fatkeqësive, bëjmë avokati për përdorim më të mirë të burimeve dhe kapaciteteve në drejtim të përmirësimit të shërbimeve për publikun dhe komunitetet e rrezikuara.

Por më shumë duhet bërë për të përmirësuar mënyrat e komunikimit të cilat u mundësojnë komuniteteve në rrezik të ndajnë historitë e tyre në lidhje me vulnerabilitetin dhe arsyet, duke i trajtuar ata jo thjesht si një audiencë pasive, por si partnerë në procesin e të mësuarit dhe të përshtatjes.

Ne punojmë për të zhvilluar një qasje strategjike në komunikim duke promovuar si komunikimin e brendshëm ashtu dhe atë të jashtëm, qasje e cila do të sjellë rritjen e numrit të palëve të interesuara për të komunikuar me ne.

Rezultatet e pritshme

▫ Shoqata ka hapësirë më të mirë ligjore për përmbushjen e misionit të saj humanitar.

▫ Mbështetje më e madhe nga strukturat qeveritare, komuniteti dhe partnerët për të rritur burimet materiale dhe financiare për të ndihmuar njerëzit vulnerabël.

3. Të bashkëpunojmë në mënyrë më efikase dhe transparente me të gjithë partnerët

Ne e shohim bashkëpunimin në tre drejtime:

- brenda Lëvizjes së Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe.
- me partnerët brenda vendit: qeverinë, agjencitë e OKB-së, shoqatat e tjera jofitimprurëse.
- në nivel lokal: midis degëve të KKSH dhe institucioneve të ndryshme në të njëjtin nivel.

KKSH është një nga aktorët humanitare më të rëndësishëm në Shqipëri, një organizatë që funksionon mirë, me të punësuar të motivuar dhe të kualifikuar dhe vullnetarë të pranishëm në të gjithë vendin.

KKSH bashkëpunon ngushtë me partnerët e tij që janë brenda Lëvizjes dhe jashtë saj. Bashkëpunimi brenda Lëvizjes ka në bazë Parimet Themelore të Lëvizjes dhe marrëveshjet e ndryshme, siç është ajo e Sevilyes, që rregullojnë rolet dhe përgjegjësitë e komponentëve të Lëvizjes, si në kohë normale ashtu edhe në periudhat e katastrofave dhe krizave.

Kryqi i Kuq Shqiptar angazhohet që të përmbushë me rigorozitet maksimal çdo përgjegjësi që buron nga Parimet e Lëvizjes, duke rritur dhe përmirësuar njëkohësisht llogaridhënien.

KKSH gjithmonë ka qenë i angazhuar për të pasur marrëdhënie të mira me qeverinë dhe strukturat përfaqësuese të saj dhe të njëjtën gjë ka kërkuar edhe prej tyre. Jo gjithmonë kemi gjetur mirëkuptim për çështje të caktuara, prandaj kjo strategji do të ketë në fokus të saj respektimin e Parimeve Themelore të Lëvizjes së KK dhe GJHK nga ana e strukturave përgjegjëse, veçanërisht parimin e Unitetit, sipas të cilit “Në një vend ka vetëm një shoqatë kombëtare të KK ose GJHK”. Do të synojmë që të kemi mbështetjen e institucioneve për realizimin e aktivitetit tonë humanitar, pasi me këto ne ndihmojmë komunitetet në nevojë, por edhe qeverinë që është përgjegjëse kryesore për sigurimin e nevojave bazë të popullatës.

Ne do të punojmë që të shtojmë marrëveshjet me strukturat e shtetit, në të cilat shoqata angazhohet të kryejë shërbime për target-grupe të caktuara të komunitetit, ndërkohë që do të synojmë të sigurojmë fonde të qëndrueshme nga qeveria, të cilat do të përdoren për realizimin e projekteve të ndryshme në shërbim të komuniteteve të rrezikuara apo në nevojë.

Në kuadër të qëndrueshmërisë financiare, është e nevojshme që në të ardhmen të investohet në mobilizimin e burimeve dhe kapacitetet profesionale që mund të ndihmojnë për të identifikuar në mënyrë të qartë burimet potenciale të rritjes së fondeve dhe për të përcaktuar një strategji specifike për të arritur objektivat vendosura në këtë fushë.

Në nivel lokal, degët e KK do të synojnë që brenda hapësirave që i lejojnë dokumentet bazë të shoqatës të formalizojnë edhe më shumë bashkëpunimin me strukturat e pushtetit vendor dhe me donatorët potencialë lokalë për projekte të caktuara, me qëllim që t'i shërbejnë sa më shumë komuniteteve të tyre sipas specifikave dhe nevojave që ato kanë.

Rezultatet e pritshme

- Bashkëpunim, koordinim dhe mbështetje më e fortë nga partnerët brenda vendit për të arritur rezultatet strategjike.
- Shoqata njihet me praktika të mira të punës që kanë partnerët brenda Lëvizjes dhe i zbaton në përshtatje me nevojat në vend.
 - Degë më të forta dhe që kanë institucionalizuar bashkëpunimin me dhe mbështetjen nga partnerët lokalë, si qeverisja vendore , biznesi dhe OJF-të.

...që prej vitit 1921 *Albanian Red Cross*



- Humanizëm
- Paanshë
- Neutritet
- Paanshë
- Vullnetarizëm
- Unifet
- Universalitet

the power of humanity



STRATEGJIA 2020

KRYQI I KUQ SHQIPTAR

Krijuar më 4 tetor 1921

Anëtar i Federatës Ndërkombëtare të Shoqatave të Kryqit të Kuq dhe Gjysmëhënës së Kuqe që prej vitit 1923.

<http://www.kksh.org.al>
www.facebook.com/kkshselia